

VENDIM
Nr. 338, datë 26.4.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 289, DATË 17.5.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË
LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE
INFORMALE (ALUIZNI)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 46 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja “a” e pikës 2 të vendimit nr. 289, datë 17.5.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) 7 (shtatë) drejtori në qarkun e Tiranës.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha